

Impakti Ekonomik i DokuFest

për periudhën 2011-2014

Shkurt 2011

Përmbledhje Ekzekutive

DokuFest është një ndër festivalet më të suksesshme dhe më të njohur në botë për filma dokumentar dhe atyre te metrazhit të shkurtër. Në këtë festival, i cili mbahet zakonisht në javën e fundit të korrikut, në qytetin e Prizrenit, marrin pjesë artist të shumtë nga vende të ndryshme të botës. Ndikimi i DokuFest në jetën kulturore të vendit është një aspekt i cili është vlerësuar tashmë nga shumë njohës të kësaj fushe.

Por ajo çfarë nuk është vlerësuar asnjëherë deri më tani është impakti që DokuFest ka në ekonominë e Kosovës në përgjithësi, dhe në atë të Komunës së Prizrenit në veçanti. Andaj, kjo analizë e Institutit për Studime të Avancuara GAP analizon pikërisht këtë: **impaktin ekonomik të DokuFest**. Analiza bazohet në të dhënat zyrtare të ofruara nga organizatorët e festivalit dhe nxjerr në pah se DokuFest jo vetëm që ka një impakt të madh për jetën kulturore, ai ka edhe një ndikim të madh dhe të shumanshëm për ekonominë e vendit. Përfitues të drejtpërdrejtë nga festivali i DokuFest janë bizneset lokale në qytetin e Prizrenit, si: kafe-baret, restorantet, shitësit ambulant, hotelet, qiradhënësit, etj., por edhe bizneset në nivel kombëtar, si avio-kompanitë, bankat apo kompanitë e telekomunikacionit.

Nëse bazohemi në numrin e vizitorëve të festivalit të fundit, ndikimi i DokuFest 2011 në Bruto Produktin Vendor (GDP) kap vlerën vjetore prej mbi 3.1 milion euro, kurse nëse llogariten edhe shpenzimet për konsum, impakti vjetor arrin në 3.8 milion euro. Nga kjo del se në periudhën e ardhshme katër vjeçare impakti i DokuFest në GDP-në e vendit të jetë së paku 17.5 milion euro, kurse nëse llogaritet edhe shpenzimet e konsumit atëherë kjo vlerë arrin deri në 21.9 milion euro.

Ky studim nxjerr si përfundim se DokuFest ka një ndikim shumëfish më të madh në ekonominë e vendit se sa buxheti me të cilin operon, andaj komunat dhe Qeveria e Kosovës duhet të krijojnë kushte për funksionimin e organizimeve të tilla të cilat kanë potencial që investimet e vogla t'i kthejnë në përfitime të mëdha për ekonominë vendore.

Metodologjia

Për shkak të informalitetit të lartë i cili ekziston në Kosovë, matja e saktë e impaktit ekonomik dhe qarkullimit të parasë në një periudhë të caktuar kohore është e vështirë. Të vetëdijshëm për këtë, organizatorët e DokuFest, kanë përpiluar një pyetësor i cili është plotësuar nga 800 respondent – pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga DokuFest. Numri i vizitorëve në DokuFest-in e dhjetë jubilar, i cili u mbajt më 23-31 korrik 2011, ishte mbi 10.000. Kjo bazuar në numrin e biletave të shitura për të parë filmat e shfaqur në 7 kinematë e qytetit. Mostra e anketuesve prej 800 vizitorësh është 1/11 e vizitorëve total të DokuFest, gjë që konsiderohet si një mostër gjithëpërfshirëse dhe e pranuar. Hulumtimi është bërë me vizitor rezident dhe jorezident të qytetit të Prizrenit. Hulumtimi ka zgjatur 10 ditë, po aq sa edhe vetë festivali DokuFest.

Përmes pyetësorit janë kërkuar të dhëna specifike për çdo respondent sikurse shuma e shpenzuar për ushqim dhe pije, bujtinë, transport si dhe shpenzime të tjera.

Shkurt për DokuFest

Festivali i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër DokuFest është ngjarja filmike më e madhe në Kosovë, e cila mbahet çdo vit në qytetin e Prizrenit. I krijuar në vitin 2002 si një festival i vogël i organizuar nga një grup miqsh dhe dashamirë të filmit, DokuFest ka arritur të shndërrohet në një prej ngjarjeve më të mëdha kulturore në rajon dhe ndër 25 festivalet më të mirë për filma dokumentar në botë.¹ DokuFest është i njohur për atmosferën dhe entuziazmin që i sjellë qytetit të Prizrenit, vizitorëve dhe rreth 150 vullnetarëve që punojnë gjatë festivalit. Po ashtu, festivalin e përcjellin edhe një numër aktiviteteve si punëtori, ekspozita DokuPhoto, festivali për fëmijë DokuKids, kampingu i festivalit dhe koncerte muzikore DokuNights.

Edicioni i 10-të jubilar i DokuFest ishte më i madhi i organizuar deri më tani. Gjatë festivalit u shfaqën 230 filma nga gjithsej 55 shtete të botës në 7 kinema të ndryshme në qytet. Prizreni mirëpriti më se 300 mysafirë ndërkombëtarë, përfshirë edhe personalitete të njohura. Një numër rekord i vizitorëve ndoqën shfaqjet e filmave, punëtoritë, panelet dhe koncertet.

Përpos organizimit të festivalit, DokuFesti tani për 5 vite me radhë është duke implementuar edhe projekte të tjera brenda vitit. Nëpërmjet projektit “Shkolla dhe Filmi Dokumentar – Promovimi i vlerave demokratike të drejtave të njeriut përmes filmit”, synohet shfrytëzimi i filmave dokumentar si mjete edukuese për ngritjen e vetëdijes së nxënësve kosovar në kuptimin e çështjes së të drejtave të njeriut. Me projektin e përkrahur nga Komisioni Evropian, ‘Fabrika e filmit për të drejtat e njeriut – histori nga margjinat e Kosovës’, DokuFesti i mundëson gjashtë grupeve të filmbërësve të rinj nga Ballkani të prodhojnë filmat e tyre dokumentar që adresojnë temën e të drejtave të njeriut në Kosovë.

¹ <http://edendale.typepad.com/weblog/2009/12/the-top-25-film-festivals-for-documentaries-2nd-edition-22-dokufest-kosovo.html>

Në dekadën e fundit, DokuFest ka arritur të jetë një ambasador i suksesshëm i promovimit të kulturës së Kosovës si në rajon ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Supozimet e Modelit për Impaktin Ekonomik të Dokufest

Të gjeturat e modelit të GAP për impaktin ekonomik të DokuFest janë:

1. Nga numri i gjithëmbarshtëm i vizitorëve në edicionin e 10 jubilar të DokuFest 50% e vizitoreve ishin nga Prizreni; 50% prej jashtë Prizrenit, prej të cilëve 25% ishin ndërkombëtar.
2. Shuma e shpenzuar për vizitor është nxjerrë nga të dhënat e anketës. Shpenzimet e vizitorëve prizrenas janë mesatarisht 80 euro për person (32.370 euro gjithsej për 400 të anketuar), kurse shpenzimet e vizitorëve jo-prizrenas kapin shumën 191 euro për person (76.484 euro gjithsej për 400 të anketuar). Për vizitorët jo-prizrenas dhe ndërkombëtarë supozohet se shpenzojnë rreth 25% më shumë se të tjerët.
3. Modeli paraqet dy grupe projeksionesh, atë të shpenzimit direkt duke përfshirë të gjithë konsumin dhe atë të ndikimit ekonomik që e eliminon komponentin e importit.
4. Nga totali i shpenzimeve, modeli supozon se propensiteti i importit është vetëm 20% pasi që konsiderohet se shpenzimet janë kryesisht të drejtuara nga shërbimet, e që janë vendore.
5. Pra, modeli parasheh që rritja e shpenzimeve në Prizren, e shtyre nga festivali ka edhe ndikim përtej atij të shpenzimit direkt gjatë festivalit, duke pasur parasysh se festivali krijon të ardhura shtesë për ekonominë familjare në Prizren. Në këtë kontekst supozohet një multiplikator i thjeshtë prej $\times 1.9$ që nënkupton se ndikimi ekonomik gjatë 3 viteve të shumës së shpenzuar është 90% më i lartë se shpenzimi direkt.
6. Modeli parashikon një periudhë 4 vjeçare sa i përket evenimentit duke përfshirë edhe ndikimin e tij ekonomik në 2 vite shtese, efektin e multiplikatorit.
7. Modeli parasheh 2 skenarë, atë baze me gjithsej 10.000 vizitorë dhe optimist me gjithsej 15.000 vizitorë.
8. Modeli parashikon rritje të numrit të vizitoreve nga viti në vit, gjegjësisht 20%, 25% dhe 30% për 3 vitet pasuese. Duhet të theksohet se shpenzimet për person mbesin të njëjta (që nuk është reale sepse ato së paku rriten me inflacion), por për hir të thjeshtësisë së modelit rritja potenciale e shpenzimeve për vizitor gjithashtu përfshihet në rritjen e numrit të vizitoreve, e cila si rezultat mund të jetë pak e zmadhuar.

Ndikimi në bruto produktin vendor (GDP)

			Sken. I	Sken. II		Sken. I	Sken. II		Sken. I	Sken. II		Sken. I	Sken. II		Sken. I	Sken. II	Sken. I	Sken. II
Nr. i Vizitor.			10,000	15,000		10,000	15,000		12,000	18,000		15,000	22,500		19,500	29,250		
						Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV		Total 4 vite - Ndikimi direkt	
Vendbani mi i vizitor.	Propor cioni	Shpen zimet EUR				EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	EUR	EUR
Prizren	50%	80.9	404,625	606,938		323,700	485,550	20%	388,440	582,660	25%	485,550	728,325	30%	631,215	946,823	1,828,905	2,743,358
Jashtë Prizrenit	25%	143.4	358,519	537,778		286,815	430,223	20%	344,178	516,267	25%	430,223	645,334	30%	559,289	838,934	1,620,505	2,430,757
Ndërkom bëtare	25%	239.0	597,531	896,297		478,025	717,038	20%	573,630	860,445	25%	717,038	1,075,556	30%	932,149	1,398,223	2,700,841	4,051,262
Total Shpenzimi në Prizren / Kosovë					Ndikimi direkt ne Ekonomi (GDP) në afat të mesëm													
			1,360,675	2,041,013			1,088,540	1,632,810		1,306,248	1,959,372		1,632,810	2,449,215		2,122,653	3,183,980	6,150,251
																	Ndikimi total ekonomik (Konsum) ne 6* vitet e ardhshme	
Multiplikatori i parasë ne qarkullim ne afat mesëm (3 vite)					1.9	2,068,226	3,102,339		2,481,871	3,722,807		3,102,339	4,653,509		4,033,041	6,049,561	11,685,477	17,528,215

Ndikimi në shpenzimet për konsum

			Skenari I	Skenari II		Skenari I	Skenari II		Skenari I	Skenari II		Skenari I	Skenari II		Skenari I	Skenari II	Skenari I	Skenari II
Nr. i Vizitorëve			10,000	15,000		10,000	15,000		12,000	18,000		15,000	22,500		19,500	29,250		
						Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV		Total 4 vite - Ndikimi direkt	
Origjina e vizitorëve	Proporcioni	Shuma e Shpenzuar EUR				EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	Rritja	EUR	EUR	EUR	EUR
Prizren	50%	80.9	404,625	606,938		404,625	606,938	20%	485,550	728,325	25%	606,938	910,406	30%	789,019	1,183,528	2,286,131	3,429,197
Jashtë Prizrenit	25%	143.4	358,519	537,778		358,519	537,778	20%	430,223	645,334	25%	537,778	806,667	30%	699,112	1,048,667	2,025,631	3,038,446
Ndërkombëtarë	25%	239.0	597,531	896,297		597,531	896,297	20%	717,038	1,075,556	25%	896,297	1,344,445	30%	1,165,186	1,747,779	3,376,052	5,064,077
Total Shpenzimi në Prizren / Kosovë			1,360,675	2,041,013	Ndikimi direkt në Ekonomi (prodhim vendor) në afat të mesëm	1,360,675	2,041,013		1,632,810	2,449,215		2,041,013	3,061,519		2,653,316	3,979,974	7,687,814	11,531,721
																	Ndikimi total ekonomik (Konsum) në 6* vitet e ardhshme	
Multiplikatori i parësë në qarkullim në afat mesëm (3 vite)					1.9	2,585,283	3,877,924		3,102,339	4,653,509		3,877,924	5,816,886		5,041,301	7,561,951	14,606,846	21,910,269

Përfundim

Festivali i filmave dokumentar dhe atyre të metrazhit të shkurtër DokuFest është ngjarja më e madhe kulturore që organizohet në Kosovë. Për dhjetë vjet me radhë ky festival ka joshur regjisor vendor dhe ndërkombëtar të cilët kanë shfaqur krijimtaritë e tyre filmike. Bashkë me film-bërësit edhe një numër i madh vizitorësh ia mësyjnë Prizrenit gjatë kohës së festivalit. Në edicionin e vitit 2011 mbi 10.000 vizitor u grumbulluan në Prizren ku u shfaqen mbi 230 filma. Kjo analizë argumenton se DokuFest përveç karakterit kulturor ndikon pozitivisht edhe në aspektin ekonomik. Përfituesit ekonomik të DokuFest janë në radhë të parë kafe-baret e Prizrenit, restorantet, bujtinat e hotelet lokale e deri te agjencitë turistike, institucionet bankare dhe aviokompanitë në rrafshin nacional. DokuFest ndikon pozitivisht edhe në GDP-në e vendit për 3.1 deri në 3.8 milion euro. Vizitorët lokal të DokuFest gjatë festivalit shpenzojnë mesatarisht 80 euro për person, kurse vizitorët jo-prizrenas, e që përbëjnë 50% të numrit të përgjithshëm të vizitorëve, shpenzojnë mesatarisht 181 euro për person. Impakti ekonomik i DokuFest pritët të jetë edhe më i madh në vitet e ardhshme, për shkak se parashihet rritje graduale e numrit të vizitorëve në tre vitet e ardhshme për 20, 25 dhe 30%. Kjo nënkupton se DokuFest përveç karakterit të tij kulturor pritët të rrisë edhe impaktin e tij ekonomik në periudhën 2012-2014.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.